



FEDERATA E BASKETBOLLIT TE KOSOVES
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TE KOSOVES
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

KOMISIONI I GARAVE
2022-23
Prishtinë, 17/08/2022

Nr. 474 Dt. 17.08.2022
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

VENDIM Nr. 1/2022


Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të Federatës së Basketbollit të Kosovës, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e vet të mbajtur në datën e lartpërmendur, në përbërje të plotë prej Kryesuesit Leart Hoxha dhe anëtarëve Valdet Spahija dhe Ylli Hoti, shqyrtoi dhe unanimisht miratoi këto vendime dhe rekomandime:

1. Komisioni miraton përmbajtjen e Rregullores së Punës së Komisionit dhe e procedon atë në Bordin Ekzekutiv të FBK-së për miratim;
2. Komisioni ka shqyrtuar dokumentet e paraqitura nga palët për çështjen e transferimit të lojtarit Daniel Lekndrejaj dhe konstaton se i njëjti mund të licencohet si lojtar i lirë për edicionin 2022-23 me kusht të përmbushjes së kushteve tjera të licencimit sipas akteve normative të FBK-së; dhe
3. Komisioni miraton kalendarin e garave për seniorë për edicionin 2022/23 në parim dhe i rekomandon Bordit Ekzekutiv të FBK-së miratimin e tij, organizimin e shortit dhe realizimin e të gjitha procedurave tjera të kërkuara për licencim të klubeve dhe lojtarëve për zhvillimin e edicionit të ri në afat sa më të shpejtë.

Vendimi për çështjen e transferimit të Daniel Lekndrejajt i dërgohet:

KB Peja
Daniel Lekndrejaj
KB Bashkimi
Anëtarëve të Komisionit të Garave
Komesarit të Garave
Arkivit të FBK-së

Në emër të Komisionit të Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës:


Leart Hoxha
Kryesues i Komisionit



KËSHILLË JURIDIKE:

Palët e pakënaqura me Vendimet e Komisionit të Garave mund të parashtrojnë ankesë pranë Komisionit Arbitrar të FBK-së, në formën dhe brenda afateve të përcaktuara me aktet normative të FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Small Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TE KOSOVES
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA

ARSYETIMI I KOMISIONIT TË GARAVE VENDIMI Nr. 1/2022

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 2 të Vendimit Nr.1/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I. KB Bashkimi ka paraqitur kërkesë për licencimin e lojtarit Daniel Lekndrejaj si lojtar i lirë, ndërsa KB Peja ka kontestuar regjistrimin e tij duke pretenduar se lojtari në fjalë ka kontratë valide me KB Peja.

II. Pas identifikimit të rastit nga Komisioni për Licencim dhe Regjistrim i FBK, Sekretarja e Përgjithshme ka kërkuar nga palët e përfshira: lojtari Daniel Lekndrejaj, KB Peja dhe KB Bashkimi, dërgimin e dëshmimeve dokumentare shtesë me të cilat konfirmohen faktohen pretendimet e tyre. Afati për dërgimin e dokumenteve shtesë ka qenë ora 12:00, më 17/08/2022.

III. KB Peja brenda afatit ka paraqitur: kontratën me lojtarin, korrespondencë me lojtarin në *whatsapp*, dëshmitë për kryerjen e pagesave të ndryshme në periudhën shtator 21-korrik 22 dhe është deklaruar se nuk ka dëshmi tjera për të paraqitur pas pranimit të kërkesës së Sekretares së Përgjithshme sipas pikës II më sipër.

IV. Lojtari Daniel Lekndrejaj brenda afatit ka paraqitur: kontratën me klubin, ekstraktin e pagesave në xhirollogari në periudhën shtator 21-gusht 22, dhe njoftimin për shkëputje të kontratës të datës 12/08/2022 për shkak të borxhit të pohuar në vlerë prej 4.000 euro.

V. Jashtë afatit KB Peja ka paraqitur kopjen e një korrespondence me lojtarin dhe agentin, të datës 22/07/2022, në të cilin thuhet se KB Peja "shfrytëzon të drejtën kontraktuale dhe vazhdon edhe një vit me Danijelin".

VI. Komisioni ka konstatuar se:

A. Kontrata e dërguar nga palët nuk ka qenë e deponuar në FBK me kohë (para fillimit të stinorit 2021/22);

B. Afati i kontratës mes KB Peja dhe lojtarit ka skaduar në dhjetor 2021 dhe e njëjta nuk është rinovuar gjatë kohëzgjatjes së saj, kur palët kanë mundur ta rinovojnë atë sipas nenit 12;

C. KB Peja jashtë afatit ka ofruar dëshmi se e ka njoftuar lojtarin për vazhdimin e bashkëpunimit por nuk ka ofruar dëshmi për renovimin e kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj, sipas nenit 12 të kontratës, në të cilin flitet për mundësinë e vazhdimin të bashkëpunimit edhe për një stinor.

D. Pagesat e korrikut 2022, të bëra në llogari të lojtarit dhe agentit nga KB Peja, sipas përshkrimit që klubi ka bërë për to, paraqesin shlyerje të borxheve të mbetura nga sezoni 2021/22 dhe jo avanse ose pagesa për sezonin 2022/23.

Rrjedhimisht, Komisioni ka konstatuar se KB Peja nuk ka ofruar dëshmi se ka kontratë valide me lojtarin Daniel Lekndrejaj dhe ka vendosur si në dispozitivin e pikës 2 të Vendimit 01/2022.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Young Basketball supporters:

